



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.148

2 nëntor

2009

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr.5, datë 15.10.2009	Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në komisionet e përhershme të Kuvendit	6627
Dekret nr.6277 datë 6.10.2009	Për lejim lënieje të shtetësisë shqiptare	6628
Vendim i KM nr.1008, datë 8.10.2009	Për një ndryshim në vendimin nr.115, datë 2.2.2009 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2009, në disa ministri dhe institucione qendrore”, të ndryshuar	6629
Udhëzim i MF dhe MD nr.1240/4, datë 15.9.2009	Për disa ndryshime në udhëzimin nr.13, datë 12.2.2009 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë, noterisë dhe zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”	6630
Udhëzim i MF dhe MD nr.1240/5, datë 15.9.2009	Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor gjyqësor privat	6631
Udhëzim i MF nr.42, datë 12.10.2009	Për përcaktimin e procedurave për shqyrtimin e dokumentacionit të subjekteve aplikuese për marrjen e autorizimit për organizimin e lojërave promocionale të fatit.....	6636
Vendim i ERE nr.66, datë 28.9.2009	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “EGL Albania” sh.a. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	6637
Vendim i ERE nr.67, datë 1.10.2009	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Energji ASHTA” sh.p.k.	6638
Vendim i ERE nr.68, datë 1.10.2009	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “HYDROENERGY” sh.p.k.....	6639

Vendim i ERE nr.69, datë 1.10.2009	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “GSA” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike	6640
Kërkesë e MPPTT nr.6011, datë 20.10.2009	Për shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Rruga sekondare Elbasan-Metalurgjik”	6641
	Vendim i shkurtuar për heqjen e zotësisë për të vepruar shtetasit Orel Bellovoda.....	6643
	Vendim i shkurtuar për shpalljen të vdekur të shtetasit Ferid Sanxhaku.....	6643
	Vendim i shkurtuar për shpalljen të vdekur të shtetasës Nazire Sanxhaku.....	6643
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Bashkim Xhepullari.....	6643

VENDIM
Nr.5, datë 15.10.2009

**PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE ZËVENDËSUES NË KOMISIONET E PËRHERSHME
TË KUVENDIT**

Në mbështetje të neneve 19 dhe 21 pika 3 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetares së Kuvendit, pas këshillimit me kryetarët e grupeve parlamentare,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Caktohen si anëtarë zëvendësues:

Në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut deputetët;

1. Fatos Hoxha
2. Mesila Doda
3. Ilir Bano

Në Komisionin për Ekonominë dhe Financat deputetët:

1. Osman Matalla
2. Flamur Noka
3. Besnik Dushaj

Në Komisionin për Sigurinë Kombëtare deputetët:

1. Rajmond Hoxha
2. Ndue Paluca
3. Luçiano Boçi

Në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin deputetët:

1. Luan Skuqi
2. Igli Cara
3. Ismail Hoxha

Në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik deputetët:

1. Gent Strazimiri
2. Ledina Aliolli
3. Astrit Bushati

Në Komisionin për Integrimin European deputetët:

1. Arenca Trashani
2. Albana Vokshi

Në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë deputetët:

1. Lajla Pernaska
2. Subi Hida

Në Komisionin për Politikën e Jashtme deputetët:

1. Gerti Bogdani
2. Paulina Hoti

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

DEKRET
Nr.6277, datë 6.10.2009

PËR LEJIM LËNIEJE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15,19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|-------------------------------------|---------------------------------|
| 1.Skënder Shaban Maçi (Maci) | 10.Olsi Çeço Shaliu |
| 2.Anila Nevrus Maçi (Isufi) | 11.Dorian Selim Farruku |
| 3.Elena Skënder Maçi (Maci) | 12.Alma Et’hem Clasen (Bardhi) |
| 4.Enis Skënder Maçi (Maci) | 13.Klodjana Xhevdet Cane (Çiço) |
| 5.Esmiljana Ferit Jonuzi | 14.Matthias Saimir Cane |
| 6.Elizabeta Gjon Tekos (Hila) | 15.Vanessa Saimir Cane |
| 7.Anxhelo Gjovalin Gjoka | 16.Enskid Fatmir Sinani |
| 8.Vito Avdulla Lato | |
| 9.Albana Abdulla Tiriakidis (Balla) | |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.1008, datë 8.10.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.115, DATË 2.2.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË
PËRKOHSHME, PËR VITIN 2009, NË DISA MINISTRI DHE INSTITUCIONE
QENDRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr.115, datë 2.2.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2009, për ministrinë dhe institucionet qendrore, është 2657 punonjës, sipas lidhjes nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Ngarkohet Ministria e Financave të miratojë shtesën në numrin e punonjësve me kontratë të përkohshme, sipas profesioneve dhe afateve kohore, brenda kriterëve të përcaktuara në vendimin e sipërpërmendur.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data e miratimit të tij.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Grupi	Emri i institucionit	Nr.i punonjësve
02	Kuvendi i Shqipërisë	11
03	Këshilli i Ministrave	1
04	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	58
05	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	213
06	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	815
10	Ministria e Financave	50
11	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	113
12	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	22
13	Ministria e Shëndetësisë	51
14	Ministria e Drejtësisë	31
15	Ministria e Punëve të Jashtme	16
16	Ministria e Brendshme	582
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	40
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	30
25	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	87
26	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	140
28	Prokuroria e Përgjithshme	5
30	Gjykata Kushtetuese	2
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	4
50	INSTAT	378
63	Këshilli i Lartë i Drejtësisë	2
77	Autoriteti i Konkurrencës	3

82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	1
87	Institucione të tjera Qeveritare	2
	Total	2657

UDHËZIM
Nr.1240/4, datë 15.9.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.13, DATË 12.2.2009 “PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR VEPRIME E SHËRBIME TË ADMINISTRATËS GJYQËSORE E MINISTRISË SË DREJTËSISË, PROKURORISË, NOTERISË DHE ZYRËS SË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTHME”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë

UDHËZOJNË:

1. Në titullin e udhëzimit pas fjalëve “Ministrisë së Drejtësisë” shtohen fjalët “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat”.
2. Në pjesën hyrëse të udhëzimit, te baza ligjore shtohet edhe referimi në paragrafin e parë të nenit 47 të ligjit nr.10031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat”.
3. Shtojca nr.1, tabela B, zëvendësohet me tabelën si vijon:

		Masa e tarifës në lekë	Masa e tarifës në %
B.	Tarifë për veprime që kryhen nga përbaruesi gjyqësor shtetëror dhe privat:		
1.	Për vënien në ekzekutim të vendimeve e titujve të tjerë ekzekutivë me objekt të pavleftësueshëm	3500	
2.	Për vënien në ekzekutim të vendimeve të titujve të tjerë ekzekutivë me objekt të vleftësueshëm:		
	a) kundrejt shtetasve		2 %
	b) kundrejt personave juridikë		2 %
3.	Për lajmërimet dhe veprimet e tjera të përbaruesit gjyqësor	200	
4.	Për lëshime nga përbaruesi gjyqësor të çdo lloj akti ose dokumenti të kërkuar nga të interesuarit	200	
5.	Për vënien në ekzekutim të vendimeve me objekt pension ushqimor	0	

4. Tarifat e përcaktuara sipas pikës 3 për shërbimin përbarimor gjyqësor shtetëror zbatohen mbas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.

5. Tarifat e përcaktuara sipas pikës 3 për shërbimin përbarimor gjyqësor privat zbatohen me fillimin e aktivitetit të përbaruesve gjyqësorë privatë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ministri i Drejtësisë
Enkelejdh Alibeaj

Ministri i Financave
Ridvan Bode

UDHËZIM
Nr.1240/5, datë 15.9.2009

**PËR CAKTIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMET E OFRUARA NGA SHËRBIMI
PËRMBARIMOR GJYQËSOR PRIVAT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe paragrafit të dytë të nenit 47 dhe nenit 48 të ligjit nr.10031, datë 11.12.2009 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë

UDHËZOJNË:

I. Shpërblimi i subjekteve përmbaruese

1. Tarifa vihet për një veprim procedural të një subjekti përmbarues.
2. Subjekti përmbarues ka të drejtë të vendosë një tarifë në masën dhe sipas procedurës së parashikuar në këtë akt.

II. Parime për përcaktimin e tarifës përmbarimore

1. Tarifa i një subjekti përmbarimor përbëhet nga një tarifë normale, përveç tarifës shtesë që mund të vihet sipas kushteve të nenit 48 të ligjit nr.10031, datë 11.12.2009 “Për shërbimin përmbarimor privat” dhe shpenzimeve, sipas nenit 525 të Kodit të Procedurës Civile. Norma e tarifës bazë të subjektit përmbarimor përcaktohet si një shumë fikse, bazuar në vlerën e tarifës dhe shpenzimeve të nevojshme për kryerjen e një veprimi përmbarimor.

2. Në rastet e parashikuara me ligj, një subjekt përmbarimor ka të drejtë të kërkojë tarifë shtesë për kryerjen e veprimeve përmbarimore.

III. Shpenzimet sipas nenit 525 të Kodit të Procedurës Civile

Shpenzimet sipas nenit 525 të Kodit të Procedurës Civile përbëhen nga shpenzimet e nevojshme për kryerjen e procedurës përmbarimore për ekzekutimin e një titulli ekzekutiv, duke përfshirë:

1. shpenzimet për administrimin e të dhënave të nevojshme për kryerjen e procedurave të ekzekutimit;
2. shpenzimet për korrespondencën në lidhje me procedurën përmbarimore;
3. shpenzimet në lidhje me transportin, magazinimin, ruajtjen e sendeve të sekuestruara dhe shpenzime të tjera në lidhje me ruajtjen e pasurisë;
4. shpenzimet në lidhje me hapjen, inventarizimin, mbylljen, lëvizjen, prishjen dhe pastrimin e ambienteve ose subjekteve të tjera në proces ekzekutimi;
5. shpenzimet në lidhje me praninë e detyruar të debitorit;
6. shpenzimet e organizimit të ankandit, duke përfshirë shpenzimet në lidhje me pagesën e çmimit të blerjes.

Shpenzimet e ndihmës ligjore të përdorura nga subjekti përmbarimor ose paditësi, me qëllim zgjidhjen e çështjeve ligjore, që kanë dalë me fillimin e procedurës përmbarimore ose gjatë gjykimit, nuk janë konsideruar të jenë shpenzime të nevojshme. Shpenzimet e menaxhimit të zyrës së subjektit përmbarimor nuk konsiderohen të jenë shpenzime të nevojshme.

IV. Personat që duhet të paguajnë tarifën e subjektit përmbarues

1. Debitori, ndaj të cilit ka filluar procedura e ekzekutimit të urdhrit të ekzekutimit, detyrohet t'i paguajë tarifën subjektit përmbarimor në përfundim të procesit të ekzekutimit. Në rastet e ekzekutimeve të suksesshme, personi përgjegjës për pagimin e tarifës është kreditori.

2. Debitori solidar është në mënyrë solidarë përgjegjës për pagesën e tarifës së subjektit përmbarues.

3. Me kërkesë të një debitori ose kërkuesi, një subjekt përmbarues paraqet provë dokumentuese për kostot e përmbarimit.

V. Mbledhja e tarifave përmbarimore

1. Në rast të përmbushjes së detyrimeve financiare ose përmbushjes së detyrimeve jo financiare, tarifat mblihen me përfundimin e veprimeve përmbarimore, përveç rasteve të parashikuara në ligj.

2. Në rast të përmbushjes së detyrimit përpara përfundimit të afatit të ekzekutimit vullnetar, tarifa bazë e subjektit përmbarues, që është paguar nga debitori, kthehet në masën e gjysmës së shumës të parashikuar në këtë udhëzim.

3. Nëse ky detyrim financiar, që i nënshtrohet ekzekutimit të detyrueshën mblihet pjesërisht, subjekti përmbarues mund të mbledhë, si tarifë të tij/saj, vetëm një shumë proporcionale me vlerën e mbledhur të detyrimit.

4. Tarifa shtesë për një veprim përmbarimor specifik mblihet menjëherë pas kryerjes së veprimit përmbarimor, siç është parashikuar në nenin 48 të ligjit.

VI. Parapagimi i tarifës përmbarimore

1. Një subjekt përmbarues është i detyruar të marrë parapagim nga kreditori kërkuesi përpara procedurës së ekzekutimit, siç parashikohet në ligj. Nëse kreditori kërkuesi nuk parapaguan, një subjekti përmbarues nuk i lejohet të fillojë procedurën e ekzekutimit. Në këtë rast, subjekti përmbarues i kthen kreditorit (kërkuesit) menjëherë dokumentet ligjore të paraqitura prej tij.

2. Parapagimi nuk kërkohet nga:

a) një person fizik që paraqet për ekzekutim një vendim të marrë gjatë procedimit gjyqësor, ku personi fizik ka qenë plotësisht ose pjesërisht i çliruar nga pagesa për ndihmë juridike ose pagesa e një tarife shtetërore, për shkak të paaftësisë paguese;

b) një person fizik që paraqet për ekzekutim një vendim të marrë gjatë procedimit penal me të cilin shlyhet një detyrim për kompensim të një dëmi të shkaktuar personit fizik në një vepër penale;

c) një person fizik që paraqet për ekzekutim një pretendim për detyrim ushqimor.

3. Nëse ka kreditorë të ndryshëm për vënien në ekzekutim të një urdhri ekzekutimi, ata parapaguan sipas marrëveshjes reciproke.

VII. Procedura për marrjen dhe kthimin e parapagesës të tarifës për subjektin përmbarues

1. Parapagimi i në tarife të subjektit përmbarues bëhet në llogarinë bankare zyrtare të një subjekti përmbarues. Një subjekt përmbarues i lëshon kreditorit një faturë për parapagesën, që përcakton të dhënat e dokumentit të ekzekutimit dhe emrin e debitorit.

2. Nëse një tarifë e subjektit përmbarues mblihet nga debitori plotësisht, subjekti përmbarues i kthen kreditorit parapagesën brenda dhjetë ditë pune pas marrjes së tarifës nga debitori.

3. Nëse procedura e ekzekutimit përfundon pa shlyerjen e detyrimit ose debitori ka përmbushur pretendimin në lidhje me kreditorin në përputhje me kërkesat përpara se ai të paraqesë një ankesë të subjekti përmbarues, parapagesa nuk i kthehet kreditorit dhe subjekti përmbarues mban tarifën për mbulimin e kostove të procedurës së ekzekutimit. Kreditori informohet me shkrim nga subjekti përmbarues për refuzimin e kthimit të parapagesës.

VIII. Tatimi mbi vlerën e shtuar

1. Tatimi mbi vlerën e shtuar i shtohet tarifës së mbledhur nga një subjekt përmbarues privat.

2. Tarifat përmbarimore i nënshtrohen ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”.

IX. Normat e tarifave që duhen paguar bazuar në vlerën e padisë

1. Nëse urdhri i ekzekutimit për pagesën nga debitori të një shume deri në 500 000 lekë për kreditorin dorëzohet për ekzekutim, parapagesa e tarifës të subjektit përmbarues llogaritet sipas vlerës së detyrimit dhe normës së tarifës së subjektit përmbarues, të përcaktuar në tabelën e mëposhtme:

Vlera e padisë për pagesë deri në...lekë	Norma e tarifës së subjektit përmbaues në lekë. Tarifa bazë	Parapagesa e tarifës së subjektit përmbaues në lekë. Tarifa për veprime procedurale
10 000	6000	5000
20 000	7000	5200
30 000	8000	5300
40 000	9000	5400
50 000	10 000	5500
60 000	11 000	5600
70 000	12 000	5700
80 000	13 000	5800
90 000	14 000	5900
100 000	15 000	6000
150 000	17 000	6500
200 000	18 000	7000
250 000	20 000	7500
300 000	22 000	8000
350 000	24 000	8500
400 000	26 000	9000
450 000	28 000	9500
500 000	30 000	10 000

2. Nëse paraqiten për ekzekutim nga kërkuesi dokumentet ligjore për pagimin e detyrimit nga debitori të një shume që kalon 500 000 lekë, tarifa e subjektit përmbaues llogaritet si më poshtë:

a) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë padie prej 500 001 deri në 600 000 lekë, është 5.8% e vlerës së padisë;

b) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë padie prej 600 001 deri në 700 000 lekë është 5.6% e vlerës së padisë;

c) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë padie prej 700 001 deri në 800 000 lekë është 5.4% e vlerës së padisë;

d) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë padie prej 800 001 deri në 900 000 lekë është 5.2% e vlerës së padisë;

e) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë padie prej 900 001 deri në 1 000 000 lekë është 5.0% e vlerës së padisë;

f) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë 1 000 001 deri në 2 000 000 lekë është 4.8% e vlerës së padisë;

g) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë padie prej 2 000 001 deri në 4 000 000 lekë është 4.6% e vlerës së padisë;

h) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë padie prej 4 000 001 deri në 6 000 000 lekë është 4.4% e vlerës së padisë;

i) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë padie prej 6 000 001 deri në 8 000 000 lekë është 4.2% e vlerës së padisë;

j) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë prej 8 000 001 deri në 10 000 000 lekë është 4.0% e vlerës së padisë;

k) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë padie prej 10 000 001 deri në 20 000 000 lekë është 3.8% e vlerës së padisë;

l. Tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë padie prej 20 000 001 deri në 30 000 000 lekë është 3.6% e vlerës së padisë;

m) tarifa e subjektit përmbaues për një vlerë padie prej 30 000 001 deri në 40 000 000 lekë është 3.4% e vlerës së padisë;

n) tarifa e subjektit përmbareues për një vlerë padie prej 40 000 001 deri në 50 000 000 lekë është 3.2% e vlerës së padisë;

s) tarifa e subjektit përmbareues për një vlerë prej 50 000 001 deri në 60 000 000 lekë është 3.0% e vlerës së padisë;

t) tarifa e subjektit përmbareues për një vlerë prej 60 000 001 deri në 70 000 000 lekë është 2.8% e vlerës së padisë;

v) tarifa e subjektit përmbareues për një vlerë prej 70 000 001 deri në 80 000 000 lekë është 2.6% e vlerës së padisë;

x) tarifa e subjektit përmbareues për një vlerë padie prej 80 000 001 deri në 90 000 000 lekë është 2.4% e vlerës së padisë.

3. Norma e tarifës së subjektit përmbareues për një padi, vlera e së cilës është më e madhe se 90 000 000 lekë është 2 160 000 lekë + 0.1% për një vlerë që kalon 90 000 000 lekë.

4. Parapagimi i një tarife të subjektit përmbareues është 20 000 lekë për vlerat e padisë, të specifikuar në nënndarjen 2 të këtij seksioni dhe 30 000 lekë për vlera të padisë të specifikuar në nënndarjen 3 të këtij seksioni.

X. Veprimet përmbareimore me norma tarifë për objekte të pavlerësueshme

1. Tarifa e subjektit të përmbareimit paguhet mbi bazën e një norme fikse për veprimet e mëposhtme përmbareimore:

a) reklamimin e një sendi të luajtshëm;

b) lirim sendi të paluajtshëm;

c) marrje fëmije dhe lejimi i së drejtës së vizitës;

d) organizimi i ankandit;

e) zbatimi i një vendimi gjykatë, nëpërmjet të cilit debitori duhet të përmbushë një detyrim të caktuar.

2. Për një veprim të përcaktuar në pikat 1,a,c, dhe e të këtij seksioni, tarifa e subjektit përmbareimor është një shumë e barabartë me gjysmën e minimumit zyrtar të pagesë mujore dhe parapagimi i një tarife të subjektit përmbareimor është një shumë e barabartë me një të tretën e pagesë minimale zyrtare mujore.

3. Në rastin e një ankandi, tarifa e subjektit përmbareimor do të jetë një shumë e barabartë me pagesë minimale mujore zyrtare.

Tarifa do të paguhet nga bashkëpronari që bën ofertën më të mirë.

4. Tarifa për lirimin e sendit të paluajtshëm është e barabartë me shumën e dy pagave minimale zyrtare mujore.

XI. Tarifa që kërkohet për paditë me objekt detyrimi ushqimor

1. Tarifa bazë që paguhet për një padi me objekt detyrim ushqimor është një shumë e plotë që përputhet me normën minimale të detyrimit ushqimor të përcaktuar me ligj. Kjo tarifë arkëtohet së bashku me pagesën e parë mujore. Nëse debitori paguan vetëm një pjesë të pagesës së detyrimit ushqimor, subjekti i përmbareimit arkëton një tarifë që është në raport me shumën e pretenduar.

2. Nëse debitori i pezullon pagesat e detyrimit ushqimor, si rezultat i të cilave kryhen veprime përmbareimore shtesë, me qëllim që të sigurohet përmbushja e mëtejshme e pretendimit, subjekti i përmbareimit ka të drejtë të kërkojë një tarifë shtesë në një shumë që përputhet me gjysmën e normës minimale të detyrimit ushqimor të parashikuar me ligj.

3. Nëse ka vonesa në pagesat e detyrimit ushqimor dhe është përcaktuar shuma e këtyre prapambetjeve, tarifa për arkëtimin e shumës së borxhit llogaritet sipas tabelës së normës së tarifave.

4. Me transferimin e një çështjeje përmbareimore nga një subjekt përmbareimor në një tjetër, nuk kërkohet pagesa e përsëritur e tarifës bazë nga debitori, me kusht që subjekti përmbareues që transferon çështjen ta ketë arkëtuar këtë tarifë.

XII. Tarifat për sigurimin e padisë

1. Një tarifë për ekzekutimin e një vendimi të ndërmjetëm, për sigurimin e padisë, bazohet në vlerën e padisë dhe paguhet si më poshtë:

a) nëse vlera e padisë është deri në 500 000 lekë, tarifa është një shumë e barabartë me një të katërtën e pagesë minimale mujore zyrtare;

b) nëse vlera e padisë është ndërmjet 500 001 dhe 2 000 000 lekë, tarifa është një shumë e barabartë me gjysmën e pagës mujore minimale zyrtare;

c) nëse vlera e padisë është më shumë se 200 000 lekë, tarifa është një shumë e barabartë me pagën minimale zyrtare mujore.

2. Nëse vendimi për sigurimin e një padie ka të bëjë me një pretendim jomonetar ose vlera e padisë nuk është e përcaktuar, në rastin e ekzekutimit të një vendimi me këtë objekt ose të revokimit të tij, tarifa e subjektit përmbarimor është një shumë e barabartë me një të tretën e pagës minimale zyrtare mujore.

3. Nëse një vendim për sigurimin e padisë ka të bëjë me një pretendim monetar dhe jomonetar, normat e tarifave të përshkruara në nënseksionet 1 dhe 2 të këtij seksioni merren në total.

4. Në rastin e ekzekutimit të një vendimi për sigurimin e padisë ose me revokimin e tij, tarifat e subjektit përmbarimor paguhën nga personi që ka bërë kërkesë për zbatimin e masës për sigurimin e padisë.

5. Tarifat e subjektit përmbarimor bëhen të arkëtueshme me paraqitjen, në rastin e ekzekutimit të detyruar, të një vendimi për sigurimin e padisë. Nëse një paditës nuk paguan tarifën e subjektit përmbarimor, ky i fundit nuk lejohet të nisë procedime përmbarimore.

XIII. Tarifat e pagueshme për kopjen e dokumenteve dhe lëshimin e certifikatave

1. Një person, që kërkon lëshimin e një kopjeje paguan për këtë kopje. Kjo dispozitë nuk zbatohet për një autoritet administrativ ose pjesëmarrës në procedim që ka të drejtë të marrë një raport mbi kryerjen e një veprimi përmbarimor, nëse ky dokument i lëshohet personit për herë të parë.

2. Tarifa e subjektit përmbarimor, për përgatitjen e një kopjeje të një dokumenti është:

a) 20 lekë për një faqe formati A4;

b) 25 lekë për një faqe format A3.

3. Një subjekt përmbarimor merr një tarifë prej 200 lekësh për lëshimin e një certifikate në lidhje me një veprim përmbarimor. Nëse certifikata jepet në lidhje me një çështje me objekt detyrim ushqimor, tarifa e subjektit përmbarimor është 60 lekë.

XIV. Tarifa shtesë e subjektit përmbarimor.

1. Një subjekt përmbarimor ka të drejtë të kërkojë një tarifë shtesë mbi bazën dhe në masën e parashikuar në ligjin përmbarimor privat, për veprimet përmbarimore teknikisht, ligjërisht komplekse ose që kërkojnë kohë. Tarifa shtesë përcaktohet në formën e një shume të plotë ose tarifë me orë. Tarifa shtesë i shtohet tarifës bazë dhe subjekti përmbarimor ka të drejtën të kërkojë pagesën e kësaj tarife vetëm nëse debitori nuk ka përmbushur detyrimin gjatë afatit të përmbushjes vullnetare dhe subjekti përmbarimor kryen një veprim përmbarimor për të cilën ai ose ajo ka të drejtë të marrë një tarifë shtesë.

2. Përveç kur parashikohet ndryshe me ligj, tarifa shtesë arkëtohet së bashku me tarifën bazë.

XV. Tarifa shtesë për veprimet e sekuestrimit

1. Një subjekt përmbarimor arkëton një tarifë shtesë në masën 0.1% të vlerës së sendit të sekuestruar për një veprim sekuestrimi të kryer jashtë zyrës së subjektit përmbarimor që përbëhet nga sekuestrimi i sendeve të luajtshme në posedim të debitorit ose për një veprim sekuestrimi në lidhje me një send të paluajtshëm.

2. Vendimi që urdhëron pagesën e një tarife shtesë nxirret pas veprimit të sekuestrimit dhe vlerësimit të sendit. Në rastin e një mosmarrëveshjeje në lidhje me sendin e sekuestruar ose çmimin e tij, vendimi që urdhëron pagesën e një tarife shtesë nxirret pas zgjidhjes së mosmarrëveshjes me kusht që sendi të mbetet i sekuestruar dhe të jetë vlerësuar.

XVI. Tarifa shtesë për mënyrat e shitjes së sendeve pasurore

Një subjekt përmbarimor merr një tarifë shtesë në një shumë prej 1% të çmimit të shitjeve të sendeve pasurore për shitjen e tyre në ankand ose në një mënyrë tjetër të lejuar nga ligji.

XVII. Tarifa shtesë në formën e tarifave për orë

Në rastin e kryerjes së një veprimi përmbarimor jashtë zyrës së subjektit përmbarimor, të përcaktuar në nënndarjen IX dhe XI të këtij udhëzimi, subjekti përmbarimor ka të drejtën të kërkojë një tarifë prej 1000 lekë duke filluar nga ora e dytë e veprimit. Detyrimi për pagesën e tarifës shtesë i lëshohet një personi që e ka shkaktuar atë dhe duhet të bëjë pagesën menjëherë pas kryerjes së veprimit përmbarimor.

Tarifat për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor gjyqësor privat zbatohen me fillimin e aktivitetit të përmbaruesve gjyqësorë privatë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ministri i Drejtësisë
Enkelejd Alibeaj

Ministri i Financave
Ridvan Bode

UDHËZIM
Nr.42, datë 12.10.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E DOKUMENTACIONIT TË
SUBJEKTEVE APLIKUESE PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT PËR ORGANIZIMIN E
LOJËRAVE PROMOCIONALE TË FATIT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 të nenit 10 të ligjit nr.10033, datë 11.12.2008, si dhe pikës 15 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.770, datë 15.7.2009 “Për mënyrën, formën, kriteret dhe rregullat shtesë për organizimin e lojërave promotionale të fatit”, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Për marrjen e autorizimit për organizimin e lojërave promotionale të fatit, subjekti aplikues duhet të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm pranë Ministrisë së Financave, drejtuar Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

2. NJMLF-ja verifikon menjëherë përputhjen e dokumentacionit me kërkesat e pikës 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.770, datë 15.7.2009.

3. Drejtori i NJMLF-së i përcjell Ministrit të Financave, brenda 2 javëve nga data e dorëzimit të kërkesës, autorizimin përkatës, së bashku me dokumentacionin shoqërues dhe argumentimin për miratimin ose jo të autorizimit, ose argumenton se aplikimi përkatës nuk përfshihet në kriteret e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave dhe nuk është e nevojshme pajisja me autorizim.

4. Ministri i Financave në vijim të procedurës së mësipërme, miraton ose jo, brenda 20 ditëve punë nga paraqitja e kërkesës në protokollin e Ministrisë së Financave, autorizimin përkatës ose e refuzon atë duke argumentuar refuzimin.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

VENDIM
Nr.66, datë 28.9.2009

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “EGL ALBANIA”
SHA NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 13, pikat 1, germa “d” dhe nenit 8 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pikat 1, germa “a” dhe 3 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.9.2009, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “EGL Albania” sh.a., për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike

dhe konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “EGL Albania” sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germa a,b dhe c) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa a,b,c,d,f dhe g) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa a,b dhe d) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10 gjerat “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “EGL Albania” sh.a. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.67, datë 1.10.2009

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGJI ASHTA” SHPK

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe 13 pika 1, germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.10.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Energji Ashta” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike

dhe konstatoi se:

Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s, lidhur me licencimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- Formatit të aplikimit (neni 9, pika 1).
- Dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2);
- Dokumentacionit financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3);
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4).

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me:

Paraqitjen e opionencës teknike të projektit është shoqëruar me informacionin për fillimin e punës për hartimin e saj (informacion i paraqitur nga aplikuesi dhe shkresë e Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore, METE, nr.6294/3, prot., datë 10.8.2009).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga “HEC Ashta”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.68, datë 1.10.2009

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“HYDROENERGY” SHPK

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1, germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.10.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hydroenergy” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike

dhe konstatoi se:

Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s lidhur me licencimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- Formatit të aplikimit (neni 9, pika 1).
- Dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2);
- Dokumentacionit financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3);
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4).
- Lejes së përdorimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike nga Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Ishëm-Erzen.

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Lidhjen me sistemin (neni 9, pika 4.1.5.a) dhe lejen e mjedisit (neni 9, pika 4.1.5.c), është shoqëruar nga informacioni se aplikuesi është ende në procesin e marrjes dhe miratimit të këtyre dy dokumenteve në institucionet përkatëse.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Hydroenergy” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.69, datë 1.10.2009

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “GSA” SHPK NË
AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a” dhe nenit 45 pikat 3,4 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pikat 1, germa “a” dhe 3 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr.21, datës 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.10.2009, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “GSA” sh.p.k. për licencim në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “GSA” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht.
 - Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1.Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “GSA” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2.Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

KËRKESË
Nr.6011, datë 20.10.2009

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Rruga sekondare Elbasan-Metalurgjik”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Sqarojmë që kjo shpallje kërkesë për shpronësim bëhet vetëm për pasurinë e llojit tokë truall dhe kulturat drufrutorë.

Pronarët për të cilët në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 132 520 (njëqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind e njëzet) lekë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “RRUGA SEKONDARE ELBASAN-METALURGJIK”

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastr.	Nr.i pasurisë	Lloji i pasurisë				Shuma	Shënime
						Truall	Drufrutorë				
							M ²	Çmimi	Vl.(lekë)		
1	Ali	Kalem	Ibrahimi	1258	150/1	20	1391	27820	61 600	89420	
2	Sabri	Kalem	Lleshanaku	1258	154/1				43 100	43100	
										132520	

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr.2484, datë 17.9.2009, vendosi pranimin e kërkesës së shtetases Irini Bellovodës për heqjen e zotësisë për të vepruar shtetasit Orel Bellovoda, i datëlindjes 27.3.1968, dhe caktimin e saj si kujdestare.

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.7453, datë 23.9.2009, vendosi shpalljen e vdekjes së shtetasit Ferit Sanxhaku, i datëlindjes 15.9.1920, vdekur më 2.5.1993 në fshatin Qatrom të rrethit Korçë.

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.7672, datë 29.9.2009, vendosi shpalljen e vdekjes së shtetases Nazire Sanxhaku, lindur më 7.1.1926, vdekur më datë 20.10.2005.

KËRKESË

Shtetasi Edmond Xhepullari kërkon shpalljen të zhdukur shtetasin Bashkim Xhepullari.

KËRKUESI
Edmond Xhepullari

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori).
 Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
 Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 30.10.2009
 Doli nga shtypi më 2.11.2009

Tirazhi: 3300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
 Tiranë, 2009

Çmimi 20 lekë